



INFORMACIONE TË SHKURTRA MBI

mbulimin dentar familjar

Ju meritoni kujdes shëndetësor të përbalueshëm.

"NY State of Health" është tregu zyrtar i planeve shëndetësore të Nju-Jorkut.

Regjistrohuni sot.



Në internet në adresën nystateofhealth.ny.gov



Me telefon në numrin
1-855-355-5777
TTY
1-800-662-1220



Kontaktoni një asistent personal në adresën info.nystateofhealth.ny.gov/findassistor

"NY State of Health" pajtohet me ligjet e zbatueshme federale dhe shtetërore për të drejtat civile dhe nuk diskriminon në bazë të racës, ngjyrës, kombësisë, besimit/fesë, gjinisë, moshës, gjendjes civile/familjare, gjendjes gjyqësore, dënimeve për vepra penale, identitetit gjinor, orientimit seksual, karakteristikave të predispozitave gjenetike, statusit ushtarak, statusit si viktimë e dhunës në familje dhe/ose hakmarrjes.

Kujdesi dentar është pjesë thelbësore e shëndetit dhe mirëqenies suaj të përgjithshme. Por ka disa gjëra që duhet t'i merrni parasysh para se të regjistroheni në një plan dentar.

1 A përfshihen përfitimet dentare familjare në planin tim "Qualified Health Plan" (QHP)?

- Nëse ju nevojitet një plan dentar që, përveç fëmijëve, mbulon edhe të rriturit, mund të:
 - Kërkoni në kontenë tuaj për QHP-të që përfshijnë përfitime dentare familjare, duke përdorur mjetin e krahasimit të planeve dentare në faqen e internetit të tregut në adresën: <https://info.nystateofhealth.ny.gov/resource/dental-plan-comparison-tool>; ose
 - Kërkoni një plan të pavarur dentar familjar jashtë QHP-së tuaj.¹
- Për një plan dentar që mbulon vetëm fëmijët, mund të merrni përfitime dentare pediatrike qoftë përmes QHP-së tuaj ose nga një plan i pavarur dentar pediatrik.²

2 Cilat shërbime mbulohe nga një plan dentar familjar?

- Planet dentare familjare kanë dy nivele të ndryshme mbulimi:
 - Përfitime dentare pediatrike
 - Përfitime dentare për të rriturit
- Përfitimet pediatrike përbëhen nga katër kategori kryesore:
 - Parandalues/Bazë
 - Rutinë
 - Shërbim i specializuar
 - Ortodonci
- Te përfitimet për të rriturit mund të përfshihen disa ose të katra kategoritë e përfitimeve.

¹ Për t'u regjistruar në një plan të pavarur dentar duhet të jeni të regjistruar fillimisht në një "Qualified Health Plan" (QHP).

² Për më shumë informacion në lidhje me përfitimet dentare pediatrike, shihni Fletën informuese të mbulimit dentar pediatrik të "NY State of Health".

INFORMACIONE TË SHKURTRA MBI

mbulimin dentar familjar

3 Cilat shërbime përfshihen në përfitimet dentare familjare?

Kategoria e shërbimit	Shembull i shërbimit	Mbulohet për fëmijët?	Mbulohet për të rriturit?
Parandalues/Bazë	Pastrime, fluorizim dhe vendosje e silanteve	Gjithmonë	Në shumicën e rasteve, në varësi të planit
Rutinë	Ekzaminime, grafi, mbushje të thjeshta dhe shkulje dhëmbi	Gjithmonë	Në disa raste, në varësi të planit
I specializuar	Kirurgji orale, këllëfë, proteza, ura dhe heqje të nervit	Gjithmonë	Në disa raste, në varësi të planit
Ortodonci	Aparate që ndihmojnë në drejtimin e dhëmbëve	Gjithmonë	Në disa raste, në varësi të planit

- Shpenzimet nga xhepi në lidhje me shërbimet dentare mund të ndryshojnë ndjeshëm në varësi të planit. Ju duhet të zgjidhni një plan që përfshin shërbimet që mendoni se i nevojiten familjes suaj.

4 Sa kushton mbulimi dentar familjar?

- Çdo plan dentar ka kosto fikse. Këtu mund të përfshihen shumat e primeve, tarifat e zbritshme, shpenzimet maksimale nga xhepi, si dhe shumat maksimale të përfitimeve vjetore. Këto kosto ndryshojnë në varësi të planit dentar.
- Përveç kostove fikse, ka kërkesa për ndarjen e kostove, të cilat gjithashtu ndryshojnë në varësi të planit. Kërkesat për ndarjen e kostove varen nga kategoria e shërbimit dhe nga fakti nëse shërbimin e përfiton një fëmijë apo një i rritur.
 - Përfitimet dentare pediatrike** kanë një limit maksimal shpenzimi nga xhepi prej 350 \$ për fëmijë ose 700 \$ për familje. Kjo është shuma maksimale që do të paguani ju gjatë çdo viti të caktuar mbulimi. Për përfitimet pediatrike nuk ka kufizim shërbimi apo periudha pritjeje.
 - Përfitimet dentare për të rriturit** zakonisht nuk kanë limit maksimal shpenzimi nga xhepi. Por mund të ketë një kufizim përfitimesh vjetore. Kjo është shuma maksimale që do të paguajë plani juaj gjatë një viti mbulimi. Jeni ju përgjegjës për shpenzimet dentare për të rriturit që tejkalojnë këtë shumë maksimale. Gjithashtu, për disa shërbime mund të ketë periudha pritjeje.³

5 Si mund të gjej një plan dentar të përshtatshëm për vete dhe familjen time?

- Mjeti i krahasimit të planeve dentare i NYSOH ju lejon të krahasoni kostot dhe përfitimet e planeve të ndryshme dentare pediatrike.⁴ Atë mund ta gjeni në faqen e internetit të tregut në adresën: <https://info.nystateofhealth.ny.gov/resource/dental-plan-comparison-tool>
- Faqja e internetit e tregut përmban edhe një mjet kërkimi të planeve shëndetësore dhe ofruesve të kujdesit shëndetësor të NYS, i cili do t'ju shfaqë një listë të ofruesve të kujdesit dentar që marrin pjesë në secilin plan. Atë mund ta gjeni në adresën: <https://pndslookup.health.ny.gov/>

³ Te planet e renditura në mjetin e blerjes në faqen e internetit të tregut shënohet "WP" nëse ka periudhë pritjeje për ndonjë prej shërbimeve të mbuluara.

⁴ Gjatë kërkimit për plane dentare, sigurohuni që po kërkoni informacion të përfitimeve për të rriturit për anëtarët e rritur të familjes, dhe jo informacion të përfitimeve pediatrike.

Si usted habla un idioma diferente al inglés, los servicios de asistencia de idioma están disponibles gratis para usted. Llame al 1-855-355-5777 (TTY: 1-800-662-1220).

如果您使用的語言不是英語，您可以使用我們的免費語言支援服務。請致電 1-855-355-5777 (TTY: 1-800-662-1220)